



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-AKP nr.02/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nenad Lazić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në çështjen juridike **të palës ankuuese;**

Komuna e Klinës, me seli në Klinë, Rr. “Abedin Rexha”, pa nr.

Kundër:

Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, (tutje, AKKVP), me seli në P.

Duke vendosur lidhur me Ankesën-padinë dhe plotësim e padisë të dt. 25.08.2023, të paraqitur nga Komuna e Klinës, kundër Vendimit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore, (tutje; KÇPB),nr. HPCC/D/176/2005/C, të datës, 29 Prill 2005, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 17 Janar 2025 merr ;

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë si e papranueshme Ankesa e ushtruar nga Komuna e Klinës, kundër Vendimit të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore, nr. HPCC/D/176/2005/C, të datës, 29 Prill 2005.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;

Komuna e Klinës me dt. 08.07.2010, parashtron padi në Gjykatën Komunale në Klinë, kundër Agjencionit Kosovar për Prona,(AKP), kundër D.Ž., nga K., dhe E.N., me kërkesë padi, të anulohen vendimet lidhur me banesën në katin I , në sipërf. Prej e cila gjendet në bllokun .+., në rr. “...” në K., dhe të PRISHEN çfarëdo qoftë e drejtë apo kontratë për shfrytëzimin apo privatizimin e kësaj banese, nga jo pronari D., ish nga K. , dhe të VËRTETOHET që Komuna e K., është titullar i të drejtës pronësore , krejt kjo në bazë të Ujdisë Gjyqësore dhe titullit përmbarrimor C.nr. 247/2007 të dt. 10.09.2007 ,në atë mënyrë që të URDHËROHET të paditurve, AKP dhe shfrytëzuesit momental që ta lirojnë këtë pronë nga personat dhe sendet dhe II., të Vërtetohet që e paditura e parë, Agjencioni Kosovar për Prona, HEQË DORË nga administrimi i më tejme i kësaj prone dhe dy banesave të tjera gjithsej tri, në këtë kompleks, dhe ti kalojnë në bashkëpronësi Komunës së Klinës.

Gjykata Themelore në Pejë –Dega në Klinë, me aktvendimin e saj, C. Nr. 92/10 të dt. 07.08.2020, shpallet jo kompetente lëndore në këtë çështje dhe lëndën ia përcjellë në kompetencë, Dhomës së

Posaçme të Gjykatës Supreme, e cila me aktvendimin e saj nr. C.II-20-0106 të dt. 07.10.2020, vendos që, Dhoma e posaçme nuk ka juridiksion për shqyrtimin e padive kundër Agjencionit Kosovar për Prona dhe lëndën ia kthen Gjykatës Themelore në Pejë –Dega në Klinë, e cila me aktvendimin tjetër C. Nr. 453/20 të dt. 24.05.2021 shpallet përsëri jo kompetente dhe lëndën ia cedon Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje administrative si gjykatë kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative pas ndërmarrjes së disa veprimeve procedurale, e hedhë poshtë padinë e paditësit Komuna e Klinës si jo të afatshme. Gjykata e Apelit në procedurë ankimore me aktvendimin, AA nr. 871/2023 të dt. 16.09.2024, e aprovon ankesën e palës ankuese Komuna e Klinës dhe lëndën e kthen në rivendosje. Me aktvendim A nr. 1372/2021 të dt. 27.09.2024, duke vepruar sipas vërejtje dhe sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative shpallet jo kompetente dhe në kuptim të nenit 15 të Ligjit për AKKVP, lëndën me të gjitha shkresat në kompetencë për të vendosur në këtë çështje ia përcjellë Gjykatës Supreme.

Gjykata Supreme pas pranimit të kësaj lënde në kompetencë, bazuar në padinë, plotësim padinë dhe parashtresën e fundit për precizimin e kërkesë padisë së paditësit Komuna e Klinës, sipas së cilës theksohet se e paditur është Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, dhe me kërkesë padi kërkohet, anulimi i vendimit HPCC/D/176/2005/C, i datës 29.04.2005 i Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore,(DÇPB), me të cilin i ishte njohur e drejta e posedimit D.Ž., në banesën lëndore objekt i këtij kontesti, shqyrtimit të akteve tjera të lëndës, përgjigjes së të paditurës dhe vendimeve të DÇPB, rezulton se;

Në Drejtorin për Çështje Pronësore Banesore, me datë 04.01.2002 është paraqitur dhe regjistruar kërkesa individuale, numër, nga pala kërkuese D.Ž., lidhur e pronën –banesën, e cila gjendet në ish Rr. “K. M”, pa nr. L/A Klinë Blloku banesor

Komisioni i shkallës së parë për Kërkesa Pronësore Banesore, (tutje KKP), i këtij organi, me Vendimin HPCC/D/176/2005/C, të datës, 29 Prill 2005, lënda DS303390, paraqitësit të kërkesës D.Z., ia njuh të drejtën e posedimit në pronën e cila gjendet në rr. “:M,,... K.,

Pas njoftimit të palës dhe publikimit të këtij vendimi, DÇPB kishte pranuar kërkesë nga pala ankuese L.N., për rishqyrtimin e këtij vendimi. Komisioni për rishqyrtim, me Vendimin grupor HPCC/REC/58/2006 të dt. 18 Shkurt 2006 e refuzon kërkesën e saj.

Paraqitësi i kërkesës së suksesshme, pas plotfuqishmërisë së vendimit dhe kërkesës së tij në AKP të dt. 10.08.2006 prona është vënë nën administrimin e AKP. Ndërsa me datë 16.02.2007 i jepet pëlqimi për inkuadrimin e pronës në skemën e qerasë të administruar nga Agjencia, pasi që i pranon kushtet nga dispozita e nenit 12.8. të Rreg. së UNMIK 2000/60.

Me rastin e vizitës së pronës nga zyrtarët e AKP-së, është gjetur në pronë L.N., të cilës i është lëshuar urdhri për dëbim me dt. 21. Maj 2008. E njëjta nuk dëbohet me që pranon që për këtë banesë të paguaj qiranë, e nënshkruan marrëveshjen për mbi Qiranë me AKP me dt. 11.09.2008.

Arsyetimi ligjor;

-Juridiksioni,

Sipas Ligjit 05/L-010, AKKVP, për veç mandatit kryesor të saj, ka trashëguar një pjesë të përgjegjësive dhe të mandatit të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe të Drejtorisë për Kërkesa Pronësore dhe Banesore, **(kësaj të fundit kryesisht lidhur me implementimin e vendimeve të sajë të plotfuqishëm), ashtu si parashihet në nenet 17-19, dhe 22.5, të këtij ligji.**

Në kuptim të nenit 15.1, të Ligjit në fuqi nr.05/-L-010 për AKKVP, kundër vendimit të Komisionit për Verifikim dhe Vendosje të Pronës, dhe kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore, palët brenda afatit prej 30 ditë, mund të paraqesin ankesë në Gjykatën Supreme për mes Sekretarisë së Agjencisë.

Megjithatë sipas këtij Ligji, (nr.05/-L-010), nuk është e paraparë që vendimet e ish Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore, përkatësisht Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore si në këtë rast, Vendimi HPCC/D/176/2005/C, të datës, 29 Prill 2005, (lënda DS 303390), dhe Vendimi grupor i shkallës së dytë HPCC/REC/58/2006 të dt. 18 Shkurt 2006, apo aktet e tjera të më vonshme të nxjerrë nga AKP apo AKKVP, si më lartë, lidhur me zbatimin këtyre vendimeve, se mund të jenë objekt i kontestimit qoftë me padi apo me ankesë në Gjykatë Supreme, për deri sa sipas neneve 17-19, dhe nenit 22. 5, të këtij ligji, si dhe rregullave dhe procedurave të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ, QRK nr. 10/2018, i nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës për Procedurat e Skemës së Kompensimit për Zbatimin e Vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore,(neni 3.1.12, dhe neni 10 parag. 8,9,12, i këtij U.A), AKKVP ka kompetencë të ekzekutoj, vendimet e plotfuqishme të Komisionit për Kërkesa Pronësore të AKP, aktgjykimet e Gjykatës Supreme, dhe **Vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, (HPCC), në zbatim të nenit 4 të Rregullores së UNMIK, nr. 2000/60,** dhe të bëjë lëshimin dhe ekzekutimin e urdhrin për dëbim, të çdo personi që është duke qëndruar në mënyrë të pa ligjshme në një pronë, të vendosur me vendim të plotfuqishëm të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (KKPB).

Sipas nenit 2.7, të Rregullores së UNMIK, nr.1999/23, të datës 15 Nëntor 1999, Vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, janë të detyrueshme për tu zbatuar **dhe nuk janë objekt i ri i shqyrtimit nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.**

Vendimi i kontestuar nga Komuna e Klinës si më lartë i DÇPB, HPCC/D/176/2005/C, i datës, 29 Prill 2005, lënda DS 303390 është i plotfuqishëm, andaj në pajtim me nenin 2, paragraf 7, të Rregullores së lartë cekur, nr. 1999/23, nuk mund të ankimohet, as sipas Rregullores së UNMIK nr.2000/60, sepse dispozitat e këtyre Rregulloreve si më lartë, në fuqi në kohën e vendosjes së kësaj çështje, si dhe aktet ligjore të më vonshme, dhe tani në fuqi që e rregullojnë këtë lëmi, nuk parashohin ndonjë mjet juridik

të rregullt apo të jashtëzakonshëm të goditjes ndaj vendimeve përfundimtare të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore.

Sipas dispozitave të Rregullores së lartë cekur, nr. 1999/23, pas vendosjes nga Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore me vendim, i cili është bërë i formës së prerë, çështja e vendosur trajtohet *res judicata*, sepse sipas nenit 2.5, të kësaj Rregullore, në çështjet e pronave banesore, juridiksioni i gjykatave lokale ishte përjashtues, ndërsa komisioni ka kompetenca ekskluzive për të zgjidhë kategoritë e kërkesave të theksuara si në nenin 1.2, të kësaj Rregullore.

Ngjashëm është edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, sa u përket vendimeve të formës së prerë të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, (shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin **me numër, KI 104/10**, e në mënyrë specifike paragrafët, 64-75, të këtij aktgjykimi).

Nga të lartë cekurat e në kuptim të nenit 16.3, parag.3.2, të Ligjit 05/L-010, për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sipas nenit 16.6, të Ligjit 05/L-010, ky aktvendim është i formës së prerë dhe i plotfuqishëm, i njëjti nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË
AC-AKP nr. 2/2024, me datë 17 Janar 2025

Bashkp. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani